


FOL

PERFORMANCA E PROKURORISË NË ZGJIDHJEN E LËNDËVE TË KORRUPSIONIT

(NË VI MUJORIN E PARË TË VITIT 2021)



PRILL 2021

Matja e efikasitetit të Institucionit të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit të gjashtë (VI) mujorit të parë të vitit 2021, sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ).

Prokuroritë e Republikës së Kosovës	PS - Lëndë të trashëguara	I - Lëndë të reja	LP -Gjithsej lëndë në punë	R - Lëndë të zgjidhura	PE - Lëndë të pazgjidhura
Prokuroria Speciale	44	38	82	30	52
PTH në Prishtinë	106	63	169	64	105
PTH në Prizren	29	34	63	29	34
PTH në Pejë	21	9	30	8	22
PTH në Gjiilan	8	26	34	15	19
PTH në Mitrovicë	83	27	110	11	99
PTH në Ferizaj	14	24	38	13	25
PTH në Gjakovë	12	11	23	8	15
Totali	317	232	549	178	371

1. FLUKSI I LËNDËVE

Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja, lëndët e trashëguara, lëndët zgjidhura dhe lëndët në pritje të zgjidhjes.

Fluksi më i lartë i lëndëve të korrupsionit:

1. Prokuroria Themelore në Prishtinë
2. Prokuroria Themelore në Mitrovicë
3. Prokuroria Speciale

Fluksi më i ulët i lëndëve të korrupsionit:

1. Prokuroria Themelore në Gjakovë
2. Prokuroria Themelore në Pejë
3. Prokuroria Themelore në Gjiilan

Prokuroritë e Republikës së Kosovës:	LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)	PE (lëndë të pazgjidhura) = LP (gjithsej lëndë në punë) - R (lëndë të zgjidhura)
Prokuroria Speciale	82 = 44 + 38	52 = 82 - 30
PTH në Prishtinë	169 = 106 + 63	105 = 169 - 64
PTH në Prizren	63 = 29 + 34	34 = 63 - 29
PTH në Pejë	30 = 21 + 9	22 = 30 - 8
PTH në Gjiilan	34 = 8 + 26	19 = 34 - 15
PTH në Mitrovicë	110 = 83 + 27	99 = 110 - 11
PTH në Ferizaj	38 = 14 + 24	25 = 38 - 13
PTH në Gjakovë	23 = 12 + 11	15 = 23 - 8
TOTAL:	549 = 317 + 232	371 = 549 - 178

2. NORMA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE (CLEARANCE RATE)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e një prokurorie në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të prokurorive.

- Norma më e lartë e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit: Prokuroria Themelore në Prishtinë (101 %);
- Norma më e ulët e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit: Prokuroria Themelore në Mitrovicë (41 %)

Prokuroritë e Republikës së Kosovës:	Norma e zgjidhjes së lëndëve % = $\frac{\text{lëndët e zgjidhura}}{\text{lëndët e reja}} \times 100$	
Prokuroria Speciale	$\frac{30}{38}$	x100=79%
PTH në Prishtinë	$\frac{64}{63}$	x100=101%
PTH në Prizren	$\frac{29}{34}$	x100=85%
PTH në Pejë	$\frac{8}{9}$	x100=89%
PTH në Gjilan	$\frac{15}{26}$	x100=58%
PTH në Mitrovicë	$\frac{11}{27}$	x100=41%
PTH në Ferizaj	$\frac{13}{24}$	x100=54%
PTH në Gjakovë	$\frac{8}{11}$	x100=73%
TOTAL:	$\frac{178}{232}$	x100=77%

3. NORMA E QARKULLIMIT TË LËNDËVE (CASE TURNOVER RATIO)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi prokurorial ose prokuroria e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Me fjalë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.

- Norma më e lartë e qarkullimit të lëndëve: Prokuroria Themelore në Prizren (0.85 %)
- Norma më e ulët e qarkullimit të lëndëve: Prokuroria Themelore në Mitrovicë (0.11 %)

Prokuroritë e Republikës së Kosovës:	Norma e zgjidhjes së lëndëve % = $\frac{\text{lëndët e zgjidhura}}{\text{lëndët e reja}} \times 100$	
Prokuroria Speciale	$\frac{30}{52}$	x100=0.58%
PTH në Prishtinë	$\frac{64}{105}$	x100=0.61%
PTH në Prizren	$\frac{29}{34}$	x100=0.85%
PTH në Pejë	$\frac{8}{22}$	x100=0.36%
PTH në Gjiilan	$\frac{15}{19}$	x100=0.79%
PTH në Mitrovicë	$\frac{11}{99}$	x100=0.11%
PTH në Ferizaj	$\frac{13}{25}$	x100=0.52%
PTH në Gjakovë	$\frac{8}{15}$	x100=0.53%
TOTAL:	$\frac{178}{371}$	x100=0.48%

4. KOHËZGJATJA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE (DISPOSITION TIME)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Pra numri 181 është numri i ditëve brenda periudhës raportuese (në këtë rast periudha VI mujore), që pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale.

- Koha më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit: Prokuroria Themelore e Prizerenit (212 ditë);
- Koha më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit: Prokuroria Themelore e Mitrovicës (1645 ditë).

Prokuroritë e Republikës së Kosovës:	Norma e zgjidhjes së lëndëve % = $\frac{181}{\text{norma e qarkullimit të lendeve}}$	
Prokuroria Speciale	$\frac{181}{0.51}$	x100=312
PTH në Prishtinë	$\frac{181}{0.61}$	x100=296
PTH në Prizren	$\frac{181}{0.85}$	x100=212
PTH në Pejë	$\frac{181}{0.36}$	x100=502
PTH në Gjiilan	$\frac{181}{0.79}$	x100=229
PTH në Mitrovicë	$\frac{181}{0.11}$	x100=1645
PTH në Ferizaj	$\frac{181}{0.52}$	x100=342
PTH në Gjakovë	$\frac{181}{0.53}$	x100=341

5. INDEKSI I LËNDËVE TË GRUMBULLUARA

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

- Indeksi më i ulët i lëndëve të grumbulluara: Prokuroria Themelore e Gjilanit (0.53);
- Indeksi më i lartë lëndëve të grumbulluara: Prokuroria Themelore e Mitrovices (7.54).

Prokuroritë e Republikës së Kosovës:	Norma e zgjidhjes së lëndëve % = $\frac{\text{lëndët e bartura (trashëguara)}}{\text{lëndët e zgjedura}} \times 100$	
Prokuroria Speciale	$\frac{44}{30}$	x100=1.46
PTH në Prishtinë	$\frac{106}{64}$	x100=1.65
PTH në Prizren	$\frac{29}{29}$	x100=1
PTH në Pejë	$\frac{21}{8}$	x100=2.62
PTH në Gjiilan	$\frac{8}{15}$	x100=0.53
PTH në Mitrovicë	$\frac{83}{11}$	x100=7.54
PTH në Ferizaj	$\frac{14}{13}$	x100=1.07
PTH në Gjakovë	$\frac{12}{8}$	x100=1.5
TOTAL:	$\frac{317}{178}$	x100=1.78

MËNYRA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE PËR PERSONA

MËNYRA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE

	Numri i kallëzimeve penale	Është hedhur kallëzimi penal	Është pushuar hetimi	Është ngritur aktakuzë	Mënyrë tjetër e zgjidhjes së lëndëve	Totali i zgjidhjes së lëndëve
Prokuroria Speciale	107	58	27	15	7	107
PTH në Prishtinë	146	49	34	60	5	148
PTH në Prizren	13	1	0	12	2	15
PTH në Pejë	9	2	5	2	0	9
PTH në Gjiilan	86	28	20	25	13	89
PTH në Mitrovicë	14	2	2	10	0	14
PTH në Ferizaj	16	1	4	11	0	16
PTH në Gjakovë	14	2	4	6	3	15
Total	405	143	96	141	30	410

Pra zgjidhja e rasteve nga ana e prokurorisë për persona është si vijon:

- Për 143 persona është hedhur kallëzimi penal;
- Për 96 persona është pushuar hetimi;
- Për 141 persona – Ngritje e aktakuzave
 - Për 12 persona –Aktakuzë e drejtpërdrejtë;
 - Për 129 persona –Aktakuzë pas procedurës hetimore;
- Për 30 persona – është zgjidhur në mënyrë tjetër (është bashkuar procedura etj.).